



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Nr. 801 prot.

Tiranë, më 08.07 2026

Nr. 1306 prot.

Tiranë, më 08.07 2026

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Lidhur ndërmjet


KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

DHE

SHKOLLA SHQIPTARE ADMINISTRATËS PUBLIKE

PËR
SHKOLLA SHQIPTARE
ADMINISTRATËS PUBLIKE

EMONA BOÇE



DREJTOR I KOMANDUAR



PËR
KOMISIONERIN PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI

GENTA Tafa (BUNGO)

KOMISIONER



Sot, më datë ____/____/2026 lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), institucion publik qendror, me NIPT L31720451U me autonomi administrative dhe akademike, që ka për qëllim formimin e nëpunësve të pushtetit qendror, pushtetit vendor, si dhe institucioneve të pavaruara, me adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark”, nr. 33, Tiranë, përfaqësuar nga **Znj. Emona Boçe, Drejtor i Komanduar;**
(në vazhdim ASPA)

dhe

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me NIPT L 02027451 K dhe adresë: Rruga Durrësit, Nr. 27, Tiranë, i krijuar me Ligjin nr.10 221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, përfaqësuar nga Komisioner, **Znj. Genta Tafa (Bungo);**

(në vazhdim KMD)

Këtu e më poshtë referuar individualisht si “**Pala**” ose bashkërisht si “**Palët**”.

Baza ligjore

Kjo marrëveshje është hartuar në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 138 datë 12.03.2014 “Për rregullat e organizimit e të funksionimit të Shkollës Shqiptare të Administratës Publike, trajnimit e nëpunësve civilë, si dhe të çdo individi tjetër jashtë shërbimit civil” i ndryshuar.

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj *Marrëveshje* është të rregullojë dhe të institucionalizojë marrëdhënien e bashkëpunimit midis palëve, për rritjen e kapaciteteve të nëpunësve të administratës publike dhe sektorit privat në fushën e respektimit të parimit të barazise dhe mosdiskriminimit, nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve, aktiviteteve informuese dhe shkëmbimit të ekspertizës.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

Për përmbushjen e qëllimit të kësaj *Marrëveshjeje*, fushat e bashkëpunimit do të fokusohen në:

2.1 Kombinimin e burimeve dhe ekspertizës për të ofruar trajnime të përbashkëta **në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi.**

- 2.2 Hartimin e kurrikulave të dedikuara për tematikat në zbatim të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe Ligjit “Për Barazinë Gjinore”, për administratën publike dhe sektorin privat;
- 2.3 Organizimin e përbashkët të trajnimeve me qëllim rritjen e kapaciteteve të nëpunësve të administratës publike, si dhe të çdo individ tjetër jashtë shërbimit civil në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit.
- 2.4 Hartimi i Udhëzuesve, materialeve informuese, organizimi i sesioneve informuese, tryezave dhe konferencave të përbashkëta.

Neni 3

Angazhimet dhe të drejtat e ASPA

- 3.1 ASPA merr përsipër të identifikojë dhe regjistrojë nevojat për pjesëmarrësit nga administrata publike, si dhe të çdo individ tjetër jashtë shërbimit civil për trajnime në fushën e barazisë dhe mosdiskriminimit.
- 3.2 ASPA angazhohet që të ofrojë mbështetje logjistike për realizimin e trajnimeve, nëpërmjet sigurimit të ambienteve ose platformave për zhvillimin e trajnimeve online.
- 3.3 ASPA me nënshkrimin e kësaj marrëveshje merr përsipër pagesën e trajnerëve sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.
- 3.4 ASPA në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse pranë KMD, ka të drejtë të ndjekë procedurat, standardet, metodologjitë për planifikimin dhe menaxhimin e zhvillimit të ciklit të plotë të trajnimit.
- 3.5 ASPA, në përfundim të trajnimit angazhohet të pajisë pjesëmarrësit me certifikatë në bashkëpunim me KMD-në.

Neni 4

Angazhimet dhe të drejtat e KMD

- 4.1 KMD merr përsipër të ofrojë ekspertë të fushës për hartimin dhe zhvillimin e kurrikulave për trajnimet në sektorin publik dhe privat, bazuar në standardet e BE-së.
- 4.2 KMD merr përsipër të ofrojë trajnerë të specializuar për realizimin e sesioneve informuese, workshop-eve dhe trajnimeve me qëllim zhvillimin e kapaciteteve të nëpunësve të administratës publike.
- 4.3 KMD ka të drejtë të vendosë për kohën dhe për periudhën e përshtatshme të realizimit të trajnimeve;
- 4.4 KMD angazhohet që të ofrojë mbështetje logjistike për realizimin e trajnimeve nëpërmjet sigurimit të ambienteve ose platformave për zhvillimin e trajnimeve online.

Neni 5

Kohëzgjatja e marrëveshjes

- 5.1 Kjo marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet nga palët pa afat dhe i shtrin efektet nga momenti i nënshkrimit të saj.

5.2 Secila palë mund të zgjidhë marrëveshjen në çdo kohë nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar palës tjetër.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis palëve

6.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj marrëveshjeje, apo të ndonjë marrëveshjeje tjetër, ose dokumenti të nënshkruar nga palët për zbatimin e saj, do të zgjidhet miqësisht nga palët, në të kundërt do të aplikohen përcaktimet e legjislacionit në fuqi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve civile.

Neni 7

Njoftimet mes palëve

7.1 Palët mund të rishikojnë zbatimin e marrëveshjes në mënyrë periodike, sa herë vlerësohet e nevojshme nga secila palë.

7.2 Çdo njoftim si dhe komunikim midis palëve lidhur me ndryshimet, shtesat apo me plotësimet që mund të lindin me kalimin e kohës për të realizuar këtë marrëveshje bashkëpunimi, do të kryhet në formë shkresore dhe do të konsiderohen si të dorëzuara rregullisht nëse dorëzohen dorazi, me postë të regjistruar, me postë elektronike ose me faks.

Për kryerjen e kësaj procedure me efikasitet, palët caktojnë personat e kontaktit që janë përkatësisht:

Për ASPA:

Person Kontakti: Geri Dule

E-mail: Geri.Dule@aspa.gov.al

Mobile: 0696754327

Për KMD:

Person Kontakti: Ada Hasa

E-mail: ada.hasa@kmd.al

Mobile: 0693501113

Palët i komunikojnë njëra-tjetrës ndryshimet e mundshme të përfaqësuesve.

Neni 8


Dispozita të Përgjithshme

8.1 Ndryshimet ose shtesat e pjesshme që do të bëhen kësaj kontrate do të jenë të vlefshme vetëm nëse bëhen me miratimin dhe nënshkrimin e të dyja palëve.

8.2 Kjo marrëveshje është e hartuar në dy kopje në gjuhën shqipe, nga një kopje për secilën palë.

PALËT

**PËR
SHKOLLA SHQIPTARE
ADMINISTRATËS PUBLIKE**

EMONA BOÇE

DREJTOR I KOMANDUAR



**PËR
KOMISIONERIN PËR MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI**

GENTA Tafa (BUNGO)

KOMISIONER

